# DËSHMI ARKIVI

**A-427443**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Tentuan të më vidhnin motorin, pastaj më qëlluan”, ra pre e një atentati në Athinë, flet 55-vjeçari shqiptar – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/tentuan-te-me-vidhnin-motorin-pastaj-me-qelluan-ra-pre-e-nje-atentati-ne-athine-flet-55-vjecari-shqiptar/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 22:46:40 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 10:20:47 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `811866d014a1ed60cc861043dbeeecb431781e45b68f27bea3dd2a7d05ce67be` |
| TEKSTI | `f3fdcd3821890c16758ffdb866c11b004ff318f62a188704b1e24868465a7ad2` |
| PAMJA | `cfc939ad03dc0edd932ef3e1d26788a159929c98b93bbd75a30d964764e2174a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5e1023e7ac03d016ec82f1d8107f574130164c8faeae0c19600794579c090b54` |
| E MËPARSHMJA | `ce1ce73776337994b7ab3d59b45ef76c237818383baa962b897b2be53bc8a5d3` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5e1023e7ac03d016ec82f1d8107f574130164c8faeae0c19600794579c090b54`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Ngjarja ndodhi pak pas orës 04:30, poshtë shtëpisë së tij. Sipas informacioneve paraprake, dy persona që lëviznin me motor hapën zjarr ndaj 55-vjeçarit.

Fatmirësisht plumbat e kapën në këmbë dhe ai u transportua në spital, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Pamjet e publikuara nga mediat greke tregojnë 55-vjeçarin të shtrirë në rrugë, ndërsa banorët e zonës i japin ndihmën e parë. Pak më vonë në vendngjarje mbërriti edhe një patrullë e Policisë Greke. Autorët u larguan në drejtim të panjohur, ndërsa policia gjeti tre gëzhoja në vendin e ngjarjes.

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

### Çfarë deklaroi 55-vjeçari

I plagosuri u ka thënë hetuesve se autorët tentuan t'i vidhnin motorin dhe se e qëlluan pasi ai u kundërpërgjigj.

Megjithatë, policia po vijon hetimet lidhur me versionin e dhënë nga shqiptari.

Në kuadër të hetimeve, në vendngjarje është thirrur edhe grupi kriminalistik për të kërkuar gjurmë gishtash në motor, pasi 55-vjeçari pretendon se autorët e kanë prekur me duar.

Hetuesit po shqyrtojnë gjithashtu faktin se vetëm pak ditë më parë ishte raportuar një tjetër incident me të shtëna në të njëjtën zonë.

Sipas informacioneve paraprake, 55-vjeçari dhe familjarët e tij nuk kanë precedent penal. Pavarësisht kësaj, autoritetet po hetojnë nëse tentativa për grabitjen e motorit ishte vërtet motivi i sulmit apo nëse pas të shtënave fshihet një tjetër shkak.

#Atentat #Greqi


**Xhuljana Zhuleku**

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.


Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



RAJONI

**Kishte dalë nga burgu me leje dhe duhej të...**

Xhuljana Zhuleku 3 minuta më parë



KOSOVA

**Kosova me Qeveri të re! Kuvendi miraton...**

Xhuljana Zhuleku Dje 17:49



KOSOVA

**Pas konstituimit të Kuvendit, Albin Kurti...**

Xhuljana Zhuleku Dje 15:26



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.